



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
MK-83
Prishtinë, më 10 nëntor 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 10 NËNTOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci Muferra Sinik dhe Slllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini dhe Xhezair Murati, kurse munguan: Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca;

Nga: NDI: Rinor Beka,

Nga OSBE: Petrit Hysa dhe

Nga: Presidenca: Lumnije Murati,

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.
Ai propozoi edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 nëntor 2009,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare më 19 nëntor 2009:
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 nëntor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 nëntor 2009, u miratua pa vërejtje.

Sabri Hamiti pati vërejtje në Transkript, në faqen 3 dhe 8, që nuk ishin regjistruar diskutimet e plota, por pjesërisht dhe atë vetëm replikat dhe në këtë mënyrë teksti ka humbur lidhshmërinë logjike. Kjo dukuri, shtoi ai, nuk ka të bëjë vetëm me transkriptin e kësaj mbledhje, por është përcjellë në vazhdimësi edhe nga mbledhjet e mëparshme.

Ai propozoi që, në të ardhmen, ose të regjistrohen diskutimet e plota, ose të mos regjistrohen ato pjesë të diskutimit që bëhen pa kyçje të mikrofonit.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me problemin që e ngriti Sabri Hamiti, vendosi që të regjistrohen dhe të transkriptohen diskutimet e plota nga mbledhjet e Kryesisë.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare më 19 nëntor 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **v e n d o s i** që në muajin nëntor të mbahen tri seanca plenare:

Më 19 nëntor 2009, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 tetor 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për borxhet publike,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetim parlamentar,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
6. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2008,

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave,
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale,
9. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë të Ekonomisë dhe të Financave për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm,
10. Njoftimi me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e deputetit Naim Rrustemi për respektimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më 20 nëntor 2009, me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Më 26 nëntor 2009, me këtë

R e n d d i t e:

1. Debat për Raportin e Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, për vitin 2009, sipas kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm

Kryesia vendosi që kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave ta radhisë për shqyrtim në seancë plenare më 19 nëntor 2009.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Punë të Jashtme për miratimin e Rregullores për formimin e Grupeve të Miqësisë

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit për Punë të Jashtme, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për formimin e Grupeve të Miqësisë.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit.

3.3 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Parlamentare e NATO-s për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit në Seancën vjeshtore, në Edinburg të Skotlandës

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, mori këtë.

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi dhe pjesëmarrja e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, Xhavit Haliti, në Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në Edinburg të Skotlandës, prej 13 deri më 17 nëntor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurin sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit..

3.4 Njoftimi me shkresën e ministrit Valton Beqiri për funksionimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore

Kryesia, pasi u njoftua me shkresën e cekur me lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport që në bashkëveprim me ministrin e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit, me ministrin e Administratës Publike dhe me kryesuesen e Këshillit për Trashëgimi Kulturore, ta shqyrtojnë problematikën e përgjegjësive dhe të fushëveprimit të tyre dhe mbi bazën ligjore Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime.
2. Kërkohet nga Këshillin për Trashëgimi Kulturore të Kosovës, si dhe nga Administrata e Kuvendit që të pezullon proceduarat e regrutimit të stafit, proceduarat e prokurimit për blerjen e dy veturave si edhe procedurën e prokurimit për objekt me qira.
3. Pezullimi do të zgjat deri në marrjen e Rekomandimit nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sporte, sipas përfundimit të Kryesisë Nr 03- P-169/K.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e udhëtimit zyrtar të Grupit Joformal të Grave në Turqi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Grupit Joformal të Grave të Kuvendit të Kosovës në Parlamentin e Turqisë, prej 01 deri më 5 dhjetor 2009.
2. Shpenzimet e qëndrimit për pjesëmarrësit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit përballohen nga buxheti i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale